



A.nr.534/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Merlinda Ramaj në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.534/2026, të datës 14.05.2026, të parashtruar nga ankuesit: F.O, A.I, S.A, E.R, S.G, N.R, XH.K, SH.B, M.SH, M.H, I.H, T.R, M.H-O, RR.R, A.A, B.P, M.G-C, F.G, F.S, Z.K, E.U, F.SH, V.B, F.A, A.Z, H.A, SH.SH, dhe K.J, të cilët sipas autorizimeve i përfaqëson Avokat: Avdyl Hyseni nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Akademia e Kosovës për Siguri Publike, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.06.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.534/2026, e datës 14.05.2026, e parashtruar nga ankuesit: F.O, A.I, S.A, E.R, S.G, N.R, XH.K, SH.B, M.SH, M.H, I.H, T.R, M.H-O, RR.R, A.A, B.P, M.G-C, F.G, F.S, Z.K, E.U, F.SH, V.B, F.A, A.Z, H.A, SH.SH, dhe K.J.

II. Mbetet në fuqi Vendimi nr.138, i datës 12.05.2026, i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike lidhur me ankuesit si në paragrafin I të dispozitivit.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.534/2026, të datës 14.05.2026, të parashtruar nga ankuesit: F.SH, V.B, F.A, A.Z dhe H.A.

IV. Lënda e ankuesve si në paragrafin III të dispozitivit bartet për shqyrtim dhe vendosje pranë Komisionit për Ankesa në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

A r s y e t i m

Ankuesit F.O, A.I, S.A, E.R, S.G, N.R, XH.K, SH.B, M.SH, M.H, I.H, T.R, M.H-O, RR.R, A.A, B.P, M.G-C, F.G, F.S, Z.K, E.U, F.SH, V.B, F.A, A.Z, H.A, SH.SH, dhe K.J, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit), më datë 14.05.2026, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.534/2026, kundër Vendimit nr. 138 të datës 12.05.2026,

lidhur më kompensimin e vlerës së përvojës së 0.25% në 0.5% nga koha kur ka hy në fuqi ligji për pagat e në vazhdimësi nga 0.50% të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Akademia e Kosovës për Siguri Publike më datë 15.05.2026 ndërsa, kjo e fundit ka dërguar përgjigjen në ankesë më datë 19.05.2026 së bashku me provat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 2292/2026, të parashtruar nga ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre Avokat Avdyl Hyseni më datë 14.05.2026, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi nr. 138 të datës 12.05.2026 i Zyrtarit të Lartë të Burimeve Njerëzore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike; Autorizimet për përfaqësim të ankuesve; Përgjigje në ankesë e datës 19.05.2026; Kërkesa e ankuesve drejtuar punëdhënësit e datës 08.05.2026; e-maili i datës 08.05.2026 dhe e-maili i datës 12.05.2026; Akt emërimet/Kontratat e punës të ankuesve; Listat e pagave të ankuesve.

I. Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesve: F.O, A.I, S.A, E.R, S.G, N.R, XH.K, SH.B, M.SH, M.H, I.H, T.R, M.H-O, RR.R, A.A, B.P, M.G-C, F.G, F.S, Z.K, E.U, SH.SH, dhe K.J. është e pabazuar, sepse:

I. Gjendja e çështjes

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se ankuesit janë të punësuar në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe atë ankuesi Fitim Osmani sipas Akt emërimit me numër protokoli 154/2025 të datës 01.07.2025, është i punësuar në pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit për Planifikim Strategjik”, Ankuesi A.I. sipas Akt emërimit me numër protokoli 140/2025 të datës 01.07.2025, është i punësuar në pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit për Marrëdhënie me Jashtë”, Ankuesi S.A, sipas Akt emërimit me numër protokoli 159/2025 të datës 08.08.2025 është i punësuar në pozitën e punës “Zyrtar i Lartë për Marrëdhënie Shumëpalëshe”, Ankuesja E.R, sipas Akt emërimit, me numër protokoli 165/2025 të datës 05.09.2025 është e punësuar në pozitën e punës “Zyrtar Administrativ”, Ankuesi S.G, sipas Akt emërimit me numër protokoli 149/2025 të datës 01.07.2025, është i punësuar në pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit për Çështje Ligjore”, Ankuesi N.R, sipas Akt emërimit me numër protokoli 157/2025 të datës 30.08.2025 është i punësuar në pozitën e punës “Zyrtar i Lartë Ligjor” në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Ankuesi Xh.K, sipas Akt emërimit me numër protokoli 151/2025 të datës 01.07.2025, është i punësuar në pozitën e punës “Menaxher i Personeli”, Ankuesi Sh.B. sipas Akt emërimit me numër protokoli 152/2025 të datës 01.07.2025 është i punësuar në pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit për Kurrikula dhe Testimeve”, Ankuesi M.Sh, sipas Akt emërimit me numër protokoli 146/2025 të datës 01.07.2025 është i punësuar në pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit për Shërbime Studentore”, Ankuesi M.H, sipas Akt emërimit të datës 29.01.2019, është i punësuar në pozitën e punës “Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim”, Ankuesi I.H, sipas Akt emërimit me numër protokoli 143/2025 të datës 01.07.2025, është i punësuar në pozitën e punës “Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm”, Ankuesi T.R, sipas Akt emërimit me numër protokoli 167/2025 të datës 29.09.2025, është i punësuar në pozitën e punës

“Zyrtar i Lartë për Trajnime”, Ankuesja M.H-O, sipas Akt emërimit me numër protokolli 122/4 të datës 06.09.2011 është e punësuar në pozitën e punës “Zyrtar e Lartë për Trajnimin e Instruktorëve”, Ankuesi Rr.R, sipas Akt emërimit të datës 01.07.2025 është i punësuar në pozitën e punës “Drejtore i Departamentit Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, Ankuesi A.A, sipas Akt emërimit me numër protokolli 139/2025 të datës 01.07.2025 është i punësuar në pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit të Trajnimeve”, Ankuesi B.P, sipas Akt emërimit me numër protokolli 169/2025 të datës 01.10.2025 është i punësuar në pozitën e punës “Zyrtar e Lartë për Trajnime”, Ankuesja M.G-C, sipas Akt emërimit, të datës 29.01.2019 është e punësuar në pozitën e punës “Zyrtar për Sigurim të Cilësisë”; Ankuesja F.G, sipas Akt emërimit, me numër protokolli 51/2026 të datës 10.02.2026 është e punësuar në pozitën e punës “Zyrtare për Vlerësim dhe Akreditim”, Ankuesja F.S, sipas Akt emërimit me numër protokolli 50/2026 të datës 10.02.2026 është e punësuar në pozitën e punës “Zyrtare për Vlerësim dhe Akreditim”, Ankuesja Z.K-Sh, sipas Akt emërimit, të datës 29.01.2019 është e punësuar në pozitën e punës “Zyrtar për Sigurim të Cilësisë”, Ankuesi E.U, sipas Akt emërimit me numër protokolli 142/2025 të datës 01.07.2025 është i punësuar në pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit për Sigurimin e Cilësisë”, Ankuesi Sh.Sh, sipas Akt emërimit, me numër protokolli 150/2025 të datës 01.07.2025 është i punësuar në pozitën e punës “Drejtore i Departamentit për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore”; Ankuesi K.J, sipas Akt emërimit me numër protokolli 144/2025 të datës 01.07.2025 është i punësuar në pozitën e punës “Drejtore i Departamentit për Trajnime dhe Përkrahjes Arsimore”.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës del se ankuesit më datë 08.05.2026, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokat Avdyl Hyseni, kanë parashtruar Kërkesë për kompensimin në emër të shtesës në pagë-përvojës së punës nga 0.25% në 0.5% ndërsa, Zyrtari i Lartë i Burimeve Njerëzore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike me Vendimin me numër të protokollit 138 të datës 12.05.2026 ka refuzuar kërkesën e ankuesve të datës 08.05.2026.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit nr. 138 të datës 12.05.2026 lidhur më kompensimin e vlerës së përvojës së 0.25% në 0.5% nga koha kur ka hy në fuqi ligji për pagat e në vazhdimësi. Pretendojnë se Vendimi i kontestuar është kontradiktor dhe juridikisht i paqëndrueshëm pasi që organi i punësimit ne njëhën anë arsyeton refuzimin me pretendimin se dispozita ligjore ende nuk është ndryshuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa, në anën tjetër institucioni ka filluar zbatimin e pagës se diferencës lidhur me shtesën me pagë-përvojës se punës 0.5% nga janari 2026. Dhe si pasojë e kësaj vendimi i atakuar është përben trajtim të pabarabartë, zbatim selektiv të ligjit dhe cenim të parimit të sigurisë juridike dhe pritjeve legjitime sepse nëse institucioni e ka konsideruar te drejtë dhe të zbatueshme pagesën nga janari 2026, atëherë, nuk ekziston bazë ligjore që e njëjta e drejtë të mohohet për periudhën paraprake sidomos kur mosrealizimi saj ka ardhur si rezultat i paqartësisë dhe mosveprimit institucional e jo për faj të ankuesve. Kërkojnë që të anulohet Vendimi me numër të protokollit 138 i datës 12.05.2026, të obligohet punëdhënësi që të bëjë kompensim e diferencës së papaguar në emër të përvojës së punës nga 0.25% në 0.5% për periudhën kohore 01.02.2024 e deri me datë 30.12.2025.

II. Vlerësimi i Kolegjit

Lidhur me pretendimin e ankuesve referuar kompensimit lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se: “6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, ref.: Nr.Ref. 2682, në pikën II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;....ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, **Gjykata do të lë në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.**

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e paragrafi 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli

në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion ligjor që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë sipas aktgjykimit kushtetues dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk mund të trajtoj në meritë pretendimin ankimor lidhur me kompensimin për përvojën e punës sikurse pretendohet në ankesë.

Thënë më tepër, e bazuar në përcaktimet kushtetuese sipas Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, Këshilli tashme ka qëndrim të konsoliduar që rregullat dhe kushtet lidhur me pagat dhe kompensimet tjera të të punësuarve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i ligjit për pagat në sektorin publik dhe se efektet e Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, referuar paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik do të rrjedhin nga data e publikim të këtij aktgjykimi (pra nga data 28.04.2024).

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, vendosi si në paragrafin I të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit, F.SH-B, V.B, F.A, A.Z, H.A, *sepse*:

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se ankuesit si në këtë pikë të arsytimit janë të punësuar në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe rrjedhimisht të njëjtit kanë themeluar marrëdhënie të punës me ASKP-ën sipas Ligjit të Punës (nr.03/L-212), Rregullores Nr. 26/2013 për Arsimimin e Lartë në AKSP dhe Rregullores Nr.25/2013 për pagesat e personelit trajnues dhe mësimdhënës në AKSP. Në fakt, ankuesja F.SH-B. sipas Kontratës së Punës për kohë të caktuar të datës 15.02.2023, mbanë pozitën e punës “*Ligjëruese*”, ankuesi V.B, sipas Kontratës së Punës për kohë të caktuar të datës 10.01.2023, mbanë pozitën e punës “*Profesor i Asocuar*”, ankuesi F.A, sipas Kontratës së Punës për kohë të pacaktuar të datës 15.04.2025, mbanë pozitën e punës “*Profesor Asistent*”, ankuesja A.Z, sipas Kontratës së Punës për kohë të caktuar të datës 05.10.2022, mbanë pozitën e punës “*Ligjëruese*”, ankuesi H.A, sipas Kontratës së Punës për kohë të caktuar të datës 20.04.2022, mbanë pozitën e punës “*Profesor Asistent*”.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës materiale të Këshillit për vendosje lidhur me çështjen në procedurë ankimore, Kolegji i Këshillit i`u referua dispozitave të nenit 5 paragrafit 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin përcaktohet se: Kategoritë e zyrtarës/it publik janë: 1.1. *Nëpunësja/i i shërbimit civil*; 1.2. *Nëpunësja/i i shërbimit publik*; 1.3. *Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës*; 1.4. *Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës*; dhe 1.5. *Zyrtarja/i i kabinetit*. 3. ***Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës....***”4. *Krijuesja/i dhe performuesja/i i artit dhe kulturës është zyrtarja/i publik që ushtron profesionin e saj/tij artistik në një institucion të artit apo të*

kulturës... andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke u bazuar në kontratat mbi themelimin e marrëdhënies së punës, Kolegji konstaton se ankuesit kanë statusin e nëpunësit publik.

Andaj, duke qenë se ankuesit nuk kanë statusin e nëpunësit civil dhe meqenëse sipas nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, atëherë, Kolegji konstaton se Këshilli nuk ka kompetenca lëndore për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesit si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Në kuptim të udhëzimit të palës ankuese lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji vë theksin të neni 8 i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 27 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se : *Nëpunësi i shërbimit publik dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë tek Komisioni i Ankesave i themeluar nga punëdhënësi, për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës. Qeveria pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor përcakton procedurën dhe rregullat për themelimin, përbërjen dhe mandatin e Komisionit të Ankesave, pra, zyrtarët publikë të kategorisë së shërbimet publik në rast të pretendimeve për shkelje të të drejtave të tyre nga marrëdhënie e punës, fillimisht mund të parashtrojnë ankesë tek punëdhënësi i cili themelon një Komision të Ankesave në pajtim me kërkesat ligjore, e më pastaj, mund të ushtrojnë padi në gjykatën kompetente në pajtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës ku shprehimisht thuhet se: **Neni 78 paragrafi 1** “... 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimi të kërkesës. **Neni 79 paragrafi 1:** Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente...”*

Marrë parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e ankueseve, atëherë, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve dhe të bartë lëndën të organi kompetent, në këtë rast të Komisioni i Ankesave në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

KËSHILLË JURIDIKE: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.534/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Përfaqësuesit të autorizuar Av.Avdyl Hyseni;*
- *Akademisë së Kosovës për Siguri Publike: Njesisë për Burime Njerëzore dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së;*